

V E N D I M
Nr.466, datë 3.10.1994

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.93, DATË 28.2.1994
“PËR BASHKIMIN E NDËRMARRJEVE SHTETËRORE NË SHOQËRITË TREGTARE ME
ORTAKË TË TJERË”

Me propozimin e Ministrisë së Burimeve Minerare dhe Energjetike, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.93, datë 28.2.1994, pas pikës 2 shtohet pika 2/a me këtë përmbajtje:

“Ministria e Burimeve Minerare dhe Energjetike miraton bashkimin e ndërmarrjeve dhe bashkësive ekonomike të sistemit të saj në shoqëri tregtare në rastet e mëposhtme:

a) Për mineralet e grupit të dytë, të tretë (përveç qymyreve dhe bitumeve) dhe të katërt të përcaktuara në tabelën shoqëruese të ligjit mineral të Shqipërisë nr.7796, datë 17.2.1994.

b) Për të gjitha veprimtaritë në sektorin e naftës e të gazit, me përjashtim të rasteve kur bashkësia ekonomike Albpetrol merr pjesë në një shoqëri tregtare:

- për kërkimin dhe zbulimin e vendburimeve të naftës e të gazit;
- për nxjerrjen e naftës e të gazit, si dhe rehabilitimin e vendburimeve ekzistuese të naftës e të gazit;

- për përpunimin e naftës;

- për bashkëpunimin në fushën e gjeologjisë për kërkimin e naftës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi